



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.2.2021, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

1. Shqyrtim në parim i projektligjit “Për miratimin e shtesës së kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të *Morpho* dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Artemis Dralo, Sadi Vorpsi, Edmond Stojku, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Nimet Musaj, Arben Elezi, Luan Duzha, Myslim Murrizi, Elena Xhina, Edmond Rrushi, Adnor Shameti dhe Lefter Maliqi.

Mungojnë:

Elona Gjebrea, Alban Zeneli, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Harusha dhe Ylli Shehu.

Të ftuar:

Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Elena Pici – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Mirëdita kolegë!

Meqenëse kuorumi është i plotë, ne mund të deklarojmë të hapur mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtim e projektligjit “Për miratimin e shtesës së kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të *Morpho* dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”. Relatore nga ana e komisionit tonë për këtë projektligj do të jetë kolegja, zonja Dhima.

Të ftuar nga Ministria e Brendshme kemi: zëvendësministren, zonjën Kuko dhe drejtorin Juridik, zotin Fatmir Shehu.

Ju kujtoj kolegë se gjatë verës ne kemi miratuar projektligjin, i cili ndryshonte afatin e vlefshmërisë së dokumentit të identitetit, të pasaportave elektronike për të gjithë ata që kishim mbushur moshën 75 vjeç, pra ata persona e kanë të vlefshme kartën e identitetit apo pasaportën deri në fund të jetës së tyre.

Në vijim të këtij vendimi të rëndësishëm që parlamenti shqiptar mori gjatë muajve të verës duke miratuar ligjin përkatës kemi dhe një shtesë të kontratës, e cila kërkohet të miratohet me ligj nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.

Për më tepër do t’ia jap fjalën zonjës Kuko për të prezantuar shtesën e kontratës, çfarë përmban kjo shtesë kontrate dhe si do të shërbejë ajo për të bërë të mundur që të gjithë personat e moshuar nga 75 vjeç e lart të mos kenë afat vlefshmërie për kartat e identitetit.

Romina Kuko - Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Përshëndetje anëtarë të nderuar të Komisionit për Sigurinë Kombëtare!

Shumë faleminderit për seancën e sotme!

Në fakt, ne jemi duke kaluar një projektligj, një ndryshim shumë të rëndësishëm, të cilin e kemi parë të domosdoshëm, sidomos gjatë kohës së pandemisë, ku një pjesë e madhe e qytetarëve e kishin të pamundur të rinovonin kartat e identitetit, sidomos të moshuarit mbi moshën 75 vjeç.

Parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin nr.89, datë 9.07. 2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8982, datë 10.10.202 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i cili parashikon se karta e identiteti ose letërnjoftimi elektronik lëshohet pa afat për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç. Për rrjedhojë ka lindur detyrimi që të amendohet edhe kontrata

koncesionare duke parashikuar se letërnjoftimi elektronik për shtetasit mbi moshën 75 vjeç ta kenë pa afat dhe të përcaktohet një *spaceman* i kësaj karte.

Me miratimin e këtij projektligji synohet ndryshimi vizual i afatit të vlefshmërisë së kartave të identitetit, që do të lëshohen për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç sipas korrespondencës që përmendet në paragrafin “e” të këtyre parashtrësive që ju i dispononi, pasqyruar në shtesën e kontratës dhe në shtojcën e re të kartës së identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç, e cila do të bëhet pjesë përbërëse dhe thelbësore e kontratës së koncesionit.

Me koncesionarin kemi pasur grupin negociator që ka dakordësuar për një ndryshim optik të kartës së identitetit, e cila duke qenë se detyrimisht duhet të përcaktohet një afat, është vendosur një afat 50-vjeçar.

Është e rëndësishme të theksohet se nuk prodhon një kosto për Autoritetin. Efektet potenciale të fitimit të munguar mund të prodhohen pas një afati 10-vjeçar nga ky amendim kontrate, periudhë në të cilën mbase do të ketë ndryshime të tjera ligjore në fuqi, target-grupi i 75-vjeçarëve nuk do të riaplikojë për letërnjoftim elektronik, duke zvogëluar kështu fitimet e kompanisë, por nga ana tjetër, theksojmë se kjo kontratë koncesionare është e vlefshme deri në datën 31.7.2023, pra nuk e kalon afatin 10-vjeçar.

Ky projektligji, po ashtu, është përcjellë edhe në zbatim të nenit 10 të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar” dhe pikës 5 të nenit 32 të vendimit nr. 575, datë 10.7.2013 të KM-së, duke i bashkëlidhur edhe raportin cilësor dhe sasior të riskut mbi implikimet fiskale për ndryshimin e kontratës. Duke qenë se këto ndryshime të kontratës nuk sjellin kosto për Autoritetin nuk shkaktojnë implikime fiskale dhe nuk kërkojnë mbështetje buxhetore dhe, nga ana tjetër, koncesionari nuk paraqet vështirësi për t’i zbatuar dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konform procedurës ligjore, bazuar pikën 1 të nenit 23 të VKM-së nr.575/2013 “Për miratimin e rregullave dhe për vlerësimin dhe dhënien me koncesion të APP-së, të ndryshuar”, ka vlerësuar dhe shprehur dakordësinë se ndryshimi i kontratës nuk paraqet risk financiar, konform procedurës së aplikuar deri tani, nda nga ana jonë lutemi për miratimin e këtij projektligji me synim aplikimin e dispozitave ligjore të sipërcituara dhe po ashtu edhe krijimin e lehtësive të mundshme të grupmoshës së tretë dhe kategorisë për lehtësimin e procesit të aplikimit për dokumentet e letërnjoftimit elektronik.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Ia kaloj fjalën relatores, zonjës Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zëvendësministren Kuko për prezantimin e këtij projektligji. Në fakt, ajo çka duhet të theksoj është se miratimi i këtij projektligji synon ndryshimin e afatit të vlefshmërisë së kartës së identitetit që do të lëshohet për shtetasit, të cilët mbushin moshën 75 vjeç, sipas korrespondencës që përmendet në paragrafin “e” të këtyre parashtrësave, e pasqyruar në këtë shtesë kontrate, si dhe në shtojcën e re 24, e cila bën fjalë për kartat e identitetit për shtetasit që mbushin moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç, e cila do të bëhet pjesë përbërëse thelbësore e kontratës së koncesionarit. Gjithashtu, kjo kontratë e miratuar me këtë projektligj ka si qëllim përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet platformës ETRUS, duke përdorur shërbimet dixhitale për verifikimin e identitetit në procesin e aplikimit për dokumentet e identifikimit (*Nuk dëgjohet*), datë 25. 02. 2008 (*Nuk dëgjohet*), si dhe specifikimet e shtojcës nr. 23, procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet shërbimeve dixhitale për verifikimin e identitetit e-Aleat, që do të bëhet pjesë përbërëse e kontratës së koncesionarit.

Projektligji ka karakter teknik, dhe normalisht nuk është planifikuar në programin analitik të akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave për vitin 2021. Autoriteti ka lidhur me koncesionarin kontratën e koncesionit, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, e cila është ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28. 7. 2008, e ndryshuar kjo me datën 13 korrik 2010, njëkohësisht ratifikuar përsëri me ligjin nr. 10322, datë 23. 9, 2010; më pas është ndryshuar përsëri, siç e thatë edhe ju në fjalën tuaj, me datën 19 mars 2013 dhe është miratuar me ligjin 129/2013.

Në përputhje me kontratën e koncesionit, koncesionari ka themeluar shoqërinë koncesionare Aleat SHPK, e cila aktualisht zbaton kontratën e koncesionit, e cila është ndryshuar. Shtesat e kontratës kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 89/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10. 10. 2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, të ndryshuar”, i cili parashikon se kartat e identitetit lëshohen pa afat për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç.

Shoqëria koncesionare i ka paraqitur autoritetit, në rastin konkret Ministrisë së Brendshme dy zgjidhje teknike të ndryshme: një zgjidhje të shpejtë dhe një zgjidhje komplekse, e cila kërkon kohë e angazhim teknik, si dhe ka efekte financiare, duke konsideruar se sistemi është projektuar dhe zbatuar për të prodhuar (*Nuk dëgjohet*) polikarboni, skalitur me laser dhe me çip të brendshëm, me një jetëgjatësi të kufizuar, për një periudhë maksimale deri në dhjetë vjet, dhe nuk ka zgjidhje teknike e teknologji të realizueshme që mundëson lëshimin e një karte identiteti biometrike (*Nuk dëgjohet*) të

kualifikuar dhe të besueshme për një periudhë kohore të pakufizuar, në përputhje kjo edhe me standardet ndërkombëtare të industrisë dhe zgjedhjen teknike, të zbatuara në vendet e BE-së.

Autoriteti ka rënë dakord të zbatojë një zgjidhje të shpejtë, e cila konsiston vetëm në një ndryshim vizual të afatit të vlefshmërisë së kartave të identitetit, të cilat do të lëshohen për shtetasit që mbushin moshën shtatëdhjetë e pesë vjeç, sipas korrespondencës që përmendet në paragrafin që përmenda pak më lart, që të mos biem në përsëritje.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar”, kjo shtesë do të sjellë përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet platformës, duke përdorur shërbimet digjitale për verifikimin e identitetit në procesin e aplikimit për dokumentet e identifikimit dhe specifikimit të shtojcës nr. 23, procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet shërbimeve digjitale për verifikimin e identitetit e-Aleat, e cila do të bëhet pjesë përbërëse e kontratës me koncesionarin.

Projektligji është i përbërë nga dy nene. Në nenin e parë përcaktohet miratimi i shtesës së kontratës për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike nëpërmjet Ministrisë së Brendshme dhe grupit përbërës, të cilët kanë krijuar firmën “Aleat” dhe në nenin 2 përcaktohet hyrja në fuqi.

Për zbatimin e këtij projektligji, normalisht, ngarkohet Ministria e Brendshme. Siç e tha edhe zëvendësministrja Kuko, në hartimin e këtij projektakti kanë marrë pjesë një grup pune i përbërë nga Ministria e Brendshme, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Miratimi i projektligjit dhe implementimi i tij nuk do të ketë efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Prandaj, të nderuar kolegë dhe kolege të deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë!

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Që të bëjmë një përmbledhje, para se të bëhen pyetje dhe diskutime në parim, prodhimi i kartave të identitetit dhe i pasaportave elektronike bëhet nëpërmjet një kontrate koncesionare prej vitesh, e cila është miratuar në parlament. Në verën e vitit që sapo mbyllëm ne ramë dakord dhe i hapëm rrugë një ndryshimi, i cili lejon që të gjithë personat nga 75 vjeç e sipër të jenë të pajisur me karta identiteti, të cilat nuk do të kenë më nevojë të rinovohen në krye të 10 vjetëve, sepse do të jenë të vlefshme deri në fund të jetës së tyre.

Në atë kohë, unë kujtoj edhe nga diskutimet që kemi pasur në komision, pyetja e shumë kolegëve, ose interesi i shumë kolegëve ka qenë nëse kjo vendimmarrje jona, natyrisht shumë pozitive për kategorinë në fjalë, do të kishte impakt te kontrata koncesionare, nëse ishte diskutuar me koncesionarin dhe nëse ishte rënë dakord me koncesionarin.

Kjo edhe në vijim të një sugjerimi, që u bë në komisionin tonë, që me kohë nga ana e Ministrisë së Brendshme të punohet me koncesionarin që të mund ta përfitonin edhe persona të moshuar mbi 70 vjeç. Sot jemi në momentin që biseda me koncesionarin është bërë. Koncesionari ka rënë dakord, dhe shtesa në kontratë do të miratohet sërish me ligj nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Megjithatë, unë nuk e vë në dyshim që nga kolegët do të ketë pyetje, sidomos të karakterit praktik, pra çfarë do të kuptojmë nga pikëpamje praktike me gjithë këtë për cilën ne po diskutojmë sot. Ne jemi komision për dhënie mendimi, pasi komisioni përgjegjës për këtë projekt do të jetë Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Do t'ju lutesha, këtu nuk është e ndaluar të bëhen pyetje të kësaj natyre, por t'u përmbahemi tagrave dhe përgjegjësiave tona, sepse tek e fundit është një komision tjetër ai që do të çmojë anën financiare të shtesës së kontratës. Neve na intereson të dimë praktikisht se si do të realizohet dhe si do të bëhet e mundur që 75-vjeçarët t'i gëzohen vërtetë një karte identiteti. A do të duhet që 75-vjeçarët që e kanë marrë tanimë kartën të paraqiten sërish pranë qendrave të koncesionarit për t'u bërë e mundur që në kartat e tyre të projektohet ky ndryshimi vizual, apo jo? Kjo është pyetja ime e parë.

Ndërkohë, i ftoj kolegët për pyetje të tjera, përpara se t'ju jap fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme.

Kolegë, kush e dëshiron fjalë? Nuk ka.

Zonja Kuko, fjala për ju.

Romina Kuko – Faleminderit

E nderuar kryetare,

Lidhur me pyetjen tuaj praktike, në fakt edhe shumë të rëndësishme për të sqaruar opinionin publik, me lejen tuaj do të doja që t'ia kaloja fjalën sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Brendshme, e cila ka qenë në pjesën e grupit që ka negociuar kontratën me autoritetin përgjegjës.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Elena Pici.

Elena Pici – Faleminderit, zonja Kuko!

E nderuar kryetare,

Ashtu, siç edhe ju e përmendët me daljen e ligjit nr. 89/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, është ngritur një grup pune në Ministrinë e Brendshme, i cili ka negociuar në mënyrë të vazhdueshme me koncesionarin për të arritur në këtë amendim kontrate koncesonare, e cila duhet thënë që nuk

vjen me kosto për autoritetin. Pra, të gjitha kostot e saj mbulohen nga ana e koncesionarit që ka pasur një negociim të vazhdueshëm në këtë aspekt.

Ashtu siç e përmendi me të drejtë edhe zëvendësministrja Kuko, kjo jo vetëm do të ketë kosto implementuese për koncesionarin në këto momente, por do të ketë edhe një fitim të munguar në kohë, duke qenë se një target grup i caktuar i popullsisë nuk do të aplikojnë më për karta të reja.

Megjithatë, ata kanë qenë shumë bashkëpunues dhe kanë marrë përsipër përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e tyre, gjë, e cila është mjaft e rëndësishme për t'u theksuar.

Në lidhje me pyetjen tuaj, ashtu siç parashikohet në shtojcën 24 të kësaj kontrate, ky implementim nga ana e koncesionarit do të përmbushet brenda 2 muajve nga miratimi i ndryshimeve të kësaj kontrate koncesionare me ligj.

Pra, nga momenti i miratimit të këtij ligji në Kuvend koncesionari do të ketë 2 muaj kohë për ta implementuar këtë ndryshim. Pas plotësimit të afatit 2-mujor, atëherë të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe do të duan të kenë një kartë, e cila optikisht do të ketë afat vlefshmërie 50 vjet mund të shkojnë ta kërkojnë atë. Megjithatë, nëse ata kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe sot zotërojnë një dokument, i cili është i vlefshëm, nuk është e thënë që ata të shkojnë të aplikojnë, por në momentin që karta që kanë do t'u skadojë, pra do të plotësojë afatin 10-vjeçar, po themi se ata mund të jenë në moshën 82-83 vjeç, atëherë në këtë moment do të shkojnë të aplikojnë dhe do të marrin një kartë pa afat. Pra, ju lind e drejta të shkojnë të aplikojnë nëse duan një kartë me afat 50-vjeçar, por, nëse sot ata zotërojnë një kartë me afat të vlefshëm, nuk kanë detyrimin të shkojnë të marrin një kartë të re me këtë afat. Është në diskrecionin e qytetarit për ta vlerësuar dhe për ta vendosur.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, nuk e di cila ka qenë arsyeja që deputetëve nuk u është vënë në dispozicion një kopje e kontratës në materialet që na janë dërguar, si me *e-mail* dhe në *WhatsApp* nga stafi i komisionit? Nuk e di pse!

Së dyti, si sekretarja e Përgjithshme dhe kolegja ime, zonja Dhima, thanë se afati i vlefshmërisë së kartës apo dhe i pasaportës është 10-vjeçar, sepse çipi i karbonit aq e ka jetëgjatësinë e tij. Tani ky çipi 50-vjeçar, se do të rrojë shqiptarët nga 130 vjet, është lloj tjetër nga çipi i zakonshëm i pasaportës që kemi unë, Qefalia, dhe Luani? Është çip ekstra për

këta që janë mbi 75 vjeç? Ky çipi ekstra për këta që rrojnë sa shqiponja sa kushton? A i zgjatet kontrata koncesionarit, kontratë e bërë në vitin 2008 midis qeverisë, parlamentit të atëhershëm dhe kompanisë ALEAT, apo jo? Nëse i zgjatet, sa? Kur i mbaron, sa do të zgjatet, pra deri kur do të shkojë ?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Cili nga përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme e do fjalën për të bërë sqarimet e pyetjeve të kolegut Murrizi?

Zonja Kuko.

Romina Kuko – Faleminderit, zonja kryetare!

Në lidhje me pyetjen e zotit Murrizi, unë e vlerësoj shumë shqetësimin e tij për pjesën teknike. Unë nuk mund të përgjigjem për pjesë teknike, por dua të flas thjesht për sa i përket iniciativës politike që kemi pasur, më pas do t'ia kaloj fjalën sërish sekretarësh së Përgjithshme, zonjës Pici, për këtë detaj.

Dua të sqaroj se ajo që kemi pasur si synim ishte të lehtësonin të moshuarit mbi moshën 75 vjeç, duke qenë se, për shembull, në raste të caktuara pamundësia e tyre për të aplikuar për karta identiteti përkthehej në kosto shtesë për këta të moshuar, sepse do të duhej që kompania ALEAT të shkonte pranë banesave të tyre dhe kjo kishte një kosto shtesë.

Gjithashtu, në kohën e pandemisë pamë se ishte shumë e vështirë për ta të merrnin shërbime, duke qenë se nuk kishin një kartë identiteti. Viti 2020 ka shënuar vitin 10-vjeçarin kur ka skaduar spektri i parë i kartave të identitetit. Kështu që është një iniciativë që u takon të gjithë shqiptarëve.

Për sa i takon pjesës së çipit, dua t'ia kaloj fjalën zonjën Pici, megjithëse ne këtu po flasim për ndryshimin vizual të kartave të identitetit. Megjithatë, zonja Pici mund t'ju japë më shumë detaje, duke qenë se ka negociuar me koncesionarët.

Faleminderit!

Myslim Murrizi - Kryetare, a ka në panel të ftuar nga kompania “Aleat”?

Ermonela Felaj- Jo. Nuk besoj se mund ta thërrasim kompaninë private në Komisionin e Sigurisë Kombëtare. Kemi të ftuar drejtorin Juridik të ministrisë.

Zonja Pici, fjala për ju.

Elena Pici – Faleminderit!

Lidhur me pyetjen që bëri zoti Murrizi, dua të sqaroj se nuk kemi një shtyrje të kontratës koncesionare me kompaninë “Aleat”. Kontrata aktuale koncesionare përfundon më 31 korrik të vitit 2023 dhe, sigurisht, grupi i punës nuk ka pasur një tagër të negociojë në

asnjë formë shtyrjen e kësaj kontrate. Kështu që, afati i kësaj kontrate mbetet i njëjtë, por sjell në vëmendjen e komisionit që në vendimin nr. 338, datë 04.11.2020, Këshilli i Ministrave ka vendosur për përcaktimin e autoritetit kontraktues për të ndërmarrë dhe zhvilluar procedurat për dhënie me koncesion partneritet publik privat të shërbimit për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrikë të identitetit. Pra, ka një vendim të Këshillit të Ministrave, që do të ketë një grup tjetër, i cili do të negociojë për këtë kontratë koncesionare pas afatit të 31 korrikut 2023, afat kur përfundon kjo kontratë. Pra, ndryshimet që po i bëjmë aktualisht kontratës koncesionare nuk sjellin në asnjë formë benefite për koncesionarin, si mund të jetë shtyrja e afatit të koncesionit.

Lidhur me pyetjen e dytë për sa i përket çipit të kartës së identitetit, dua t'ju sqaroj se ndryshimi që ne po bëjmë është vetëm një ndryshim optik dhe jo një ndryshim që mund të sjellë ndryshime elektronike brenda kartës, siç është çipi, ku, për rrjedhojë, edhe çmimi që do të paguajnë qytetarët nuk ndryshon, por vazhdon të jetë i njëjtë në vlerën 1500 lekë. Kjo është bërë me qëllim për faktin se, duke qenë se në vitin 2023 do të përfundojë kjo kontratë koncesionare dhe kushdo që do të jenë ofertuesit e radhës, një ndër kriteret tona më të rëndësishme për kontratën e re që do të negociohet, do të jetë edhe fakti që çipi për kartat e qytetarëve mbi 75 vjeç të ketë një afat vlefshmërie më të gjatë. Për momentin, afati i vlefshmërisë së çipit sipas kësaj kontrate aktuale është 10 vjet. Prandaj edhe ndryshimi që ne po bëjmë është në një nivel optik të kartës, ku, për rrjedhojë, edhe çmimi nuk ndryshon dhe vazhdon të jetë i njëjtë, 1500 lekë, për qytetarët e pajisur me të.

Myslim Murrizi – A keni ndonjë numër konkret: sa ka Shqipëria mbi 75 vjeç sot?

Ermonela Felaj – Po, faleminderit!

Mund ta kemi përgjigjen e kësaj pyetjeje?

Elena Pici – Në fakt, në këtë moment unë nuk e disponoj një numër të saktë të shtetasve mbi 75 vjeç, të cilët do të duhet të pajisen me këtë ID card, sepse nuk mjafton vetëm numri i shtetasve mbi 75 vjeç, por edhe se sa prej këtyre shtetasve, në fakt, sot nuk kanë një ID card të vlefshme, pasi për kategorinë e atyre, të cilët mund ta kenë rinovuar në vitin 2019 dhe vijojnë të kenë një kartë të vlefshme, ngelet në diskrecionin e tyre nëse duan ose jo të përfitojnë nga kjo ose mund të përfitojnë nga ky ndryshim, vetëm pasi të përfundojë afati 10-vjeçar i vlefshmërisë së kartës që kanë. Pra, nuk do të jetë e nevojshme të vijnë për një riaplikim.

Myslim Murrizi – Po ta them unë, shefe, meqenëse je e re: janë 21 342 pensionistë mbi 75 vjeç. A përbën kjo problem për kompaninë ALEAT?

Elena Pici – I nderuar deputet, kompania ka shprehur që nuk përbën asnjë problem për implementimin e këtij ndryshimi. Kompania ka firmosur amendimin e kontratës, në të cilën ka marrë përsipër edhe të gjitha kostot për këtë procedurë. Pra, kontrata është firmosur nga kompania koncesionare në këtë rast. Kështu që ata kanë marrë përsipër kryerjen dhe ofrimin e këtij shërbimi, pa asnjë kosto shtesë; kjo ka qenë pjesë edhe e raportit sasior dhe cilësor të vlerësimit të riskut që është dërguar në Ministrinë e Financave sipas detyrimeve të ligjit “Për koncesionet”.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Pici!

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk e di me zotin Murrizi jemi opozitarë, por konvergojmë në të njëjtin mendim për sa i përket pyetjes, e cila u ezaurua, domethënë se sa është numri. Gjithsesi, kjo është një vendimmarrje shumë e mirë e qeverisë shqiptare që sërish shkon në ndihmë të individëve që janë në moshën mbi 75 vjeç, por, parë në kontekstin në përgjithësi, sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Brendshme ishte shumë konkrete dhe e përkufizoi saktë se si veprohet.

Unë, në fakt, do të ndaja një mendim disi kundër, sepse, po të shikosh aspektin e moshës mesatare në Shqipëri, nuk është se i kalon mbi 80-at. Kështu që më duket nonsens që një individ, i cili ka aplikuar në moshën 74-vjeçare dhe e ka vlefshmërinë deri në moshën 84 vjeç, t’i thuhet të vijë sërish të aplikojë kur të jetë 84 e sipër. Nuk e di, ndoshta ka qenë e pamundur në negocimin që është bërë me koncesionarin. Më saktë, për ta përmbledhur mendimin, do të isha që, nëse është parë ose nëse është tentuar nga ana e propozuesit të ligjit për të pasur kontakt që këta individë, të cilët e kalojnë moshën 75, ta kenë të vlefshme. Ju u futët edhe në specifikime teknike që ndoshta nuk e ka vlefshmërinë çipi, por kjo do të ishte një gjë, e cila do të përmbushte dhe do të kënaqte këtë kategori dhe këtë moshë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia për diskutimin tuaj!

Zonja Dhima, ka kërkuar fjalën për një pyetje.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

(Nuk dëgjohet)... nga dy kolegët e mëparshëm, zoti Murrizi dhe zoti Qefalia. Unë dua të di numrin, të dhëna të sakta sesa është numri i personave.

Ermonela Felaj – *(Nuk dëgjohet)*... për të kuptuar se sa njerëz e arrijnë moshën 75 vjeç, tani që flasim dhe kanë nevojë të pajisen me kartën e identitetit pa afat vlefshmërie, si dhe sa 75-vjeçarë disponojnë karta identiteti brenda afatit 10-vjeçar ose jashtë afatit 10-vjeçar? Në këtë pikë, përsëri dua të sqaroj dy momente. Të gjithë personat që kanë mbushur

75 vjeç, deri në momentin aktual, pa hyrë në fuqi ky ndryshim i kontratës së koncesionarit, kjo shtesë e kontratës koncesionare dhe karta e tyre është e re, sepse vetëm në ligj kemi thënë që, ata do ta kenë të vlefshme këtë kartë deri në fund të vitit, pra janë pajisur ndërkohë me kartë, kjo kategori do të ketë nevojë të shkojë në zyrat e Aleat, për të marrë këtë kartë me këtë vizualizimin e ri optik dhe a do të paguajnë gjë për këtë pjesë? E para.

E dyta, nëse nuk duhet të shkojnë se karta e tyre vlen deri në fund të jetës, atëherë, pse duhet formalizuar ky ndryshim në kontratë? Se tani ose duhet të jetë dhe duhet të marrin kartën me vizualizimin e ri optik, ose përndryshe ne u themi të gjithë 75-vjeçarëve: “Keni kartën dhe e keni të vlefshme deri në fund të jetës”.

Pra, janë këto dy gjëra, për të cilat besoj se kemi interes t’i ndajmë në komisionin tonë.

Zonja Pici, meqenëse, ju keni marrë pjesë aktive në grupin e punës, për ndryshimin e kontratës, mund të na sqaroi diçka më në detaje?

Elena Pici - Po, zonja kryetare.

Në lidhje me sa ju përmendni, ndryshimi që ka ndodhur në Kuvendin e Shqipërisë, në muajin korrik për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, parashikon se shtetasit shqiptarë, mbi moshën 75 vjeç, pajisen me një dokument ID kartë pa afat. Pra, nuk është se ky ndryshim ka sjellë shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kartave të identitetit që ata posedojnë në këto momente. Pra, nëse ndryshimi ligjor në korrik do të kishte qenë: “Karta e identitetit e shtetasve mbi 75 vjeç është e vlefshme pa afat”, atëherë, ky do të ishte një moment, ku të gjithë 75- vjeçarët, nga ai moment do të kishin një kartë pa afat, e cila do t’ju shërbente dhe nuk do të kishin nevojë të shkonin të aplikonin për një kartë të re. Duke qenë se ndryshimi thotë: “Shtetasit mbi 75 vjeç pajisen me një kartë identiteti pa afat”, atëherë këtu lind nevoja për të negociuar me koncesionarin, për t’i pajisur tashmë shtetasit mbi 75 vjeç me një kontratë, e cila optikisht do të ishte pa afat, por nga ana praktike na rezultoi që duhet të kishte gjithsesi një afat dhe prandaj ai u caktua 50 vjet.

Theksoj edhe një herë ...

Ermonela Felaj – Një sekondë, ju lutem! Ndërhyrja në këto lloj mbledhjesh është e vështirë dhe duket pak e ashpër, por absolutisht nuk dua të tregoj mungesë respekti.

Nga momenti që ne bëmë ndryshimin në ligj dhe nga momenti që ai ndryshim hyri në fuqi, gusht apo shtator, deri më sot ,natyrisht që ka pasur shtetas që janë 75 vjeç dhe më shumë dhe janë pajisur me kartë të re. Për këtë kategori e kam fjalën. Këta persona do të duhet të shkojnë te zyrat e Aleatit për të marrë kartën me vizualizimin e ri optik apo jo dhe do të duhet të paguajnë gjë? Këtë gjë dua të kuptoj.

Në logjikën time, miratimi i shtesës së kontratës dhe ndryshimi që ne bëmë në ligj duhet të ishin të njëkohshëm. Biseda duhet të kishte ndodhur paraprakisht dhe pastaj të vinte ndryshimi. Besoj se këtë logjikë ndajnë të gjithë kolegët. Jeni pak në të kundërt. Pra, bëtë ndryshimin dhe pastaj po merreni vesh me koncesionarin. Sidoqoftë më intereson të di çfarë ndodh me këtë kategori nga momenti që ne bëmë ndryshimin në verë deri më sot, të cilët kanë marrë kartë identiteti dhe janë mbi 75 vjeç?

Elena Pici – Zonja kryetare, ashtu siç edhe ju e përmendët, duke qenë se procesi i amendimit të kontratës koncesionare ka ndodhur më vonë, për shtetasit të cilët janë mbi 75 vjeç dhe janë pajisur gjatë kësaj periudhe me një ID Card do të ngelet në të drejtën e tyre nëse do të duan të ripajisen me një kartë afati i të cilës është 50 vjet apo do të vazhdojnë të përdorin kartën e tyre, e cila në këto momente është e vlefshme, sepse ka afatin e vlefshmërisë 10-vjeçare. Megjithatë, në momentin që ata do të zgjedhin të shkojnë të aplikojnë për një kartë me afat 50-vjeçar, fatkeqësisht në këto momente do të duhet të paguajnë sërish tarifën prej 1500 lekësh për t'u pajisur me ID Card. Kjo nuk ndryshon.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Këtë përgjigje kërkoja.

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Murrizi.

Myslim murrizi – Meqë jemi te kartat, nuk e di sa kompetente janë, qoftë zëvendësministrja, për t'i dhënë përgjigje pyetjes për 800 mijë shqiptarë, të cilëve u mbaron afati i kartave para 25 prillit. A është parë mundësia nga ana e Ministrisë së Brendshme, që, meqë jemi në prag shtyrje afati për mbi 75-vjeçarët, të ketë një shtyrje afati njëlloj si kolaudimi i makinave për efekt pandemie deri më 30 prill, që t'u mundësohet 800 mijë shqiptarëve e drejta e votës me kartat që kanë? Periudha është shumë e ngushtë dhe nëse 800 mijë shqiptarë do të mësyjnë në dyert e Aleatit nuk ja arrijnë dot për 60 ditë të realizojnë pajisjen me karta përpos afatit 14 ditë, që duhet për të marrë kartën nga dita e aplikimit. Nuk e di kush do të përgjigjet, ndoshta zonja Kuko.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Po, zonja Kuko.

Romina Kuko – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Murrizi, për pyetjen!

Në fakt, është rast i mirë për të bërë një apel edhe për qytetarët që të vazhdojnë në aplikojnë për kartat e identitetit.

Ne, që në vitin 2020, kemi filluar një fushatë për të ndërgjegjësuar qytetarët për riaplikimin e kartave. Patëm penalizimin e pandemisë kur kishim mbylljen e sporteve të aplikimit gjatë periudhës 3-mujore të karantinimit të plotë dhe patëm një shtyrje afati deri më 31 dhjetor të vitit 2020 për ato letërnjoftime që skadonin deri në fund të vitit 2020. Dua t'ju them që Ministria e Brendshme ka vendosur në dispozicion të gjitha zyrat e Aleatit në të gjithë territorin e Shqipërisë edhe gjatë ditëve të shtuna, apo me orare të zgjatura, për t'ua lehtësuar qytetarëve aplikimin. Shqetësimi juaj është shumë i drejtë, megjithatë do të duhet të fillojmë të shohim dhe të mendojmë. Jemi duke diskutuar së brendshmi për të gjetur opsionin më të mirë dhe nuk kemi ende një verdikt për sa i përket kësaj pjese. Pa diskutim që për pjesën e votimit edhe pasaportat janë dokumente të vlefshme për votim, pra nuk është vetëm karta e ID-së. Megjithatë shqetësimi juaj është shumë i drejtë, ne do të përpiqemi të gjejmë opsionin më të mirë për sa i përket pajisjes së qytetarëve me letërnjoftim elektronik, por përfitoj nga rasti që të kërkoj, gjithashtu, edhe mbështetjen e Komisionit të nderuar të Sigurisë, por edhe të deputetëve, për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve, sepse siç e thoni dhe ju, është një afat shumë i shkurtër deri në zgjedhjet e 25 prillit.

Kryetare, nëse më lejoni, unë do të doja t'ju jepja një të dhënë të vogël, për sa u përket 75-vjeçarëve, të cilët nuk kanë një ID-i të vlefshme: nga 211 mijë e 444 shtetas mbi moshën 75 vjeç, ata janë 14 mijë e 964 dhe nuk kanë një ID të vlefshme, pjesa tjetër ka aplikuar megjithatë ndryshimet hyjnë në fuqi pas ndryshimit të kontratës. Siç e tha edhe zonja Pici, do të duhet të ketë një riaplikim për të pasur kartën e re vizuale me shtyrjen për 14 mijë e 964 shtetas mbi moshën 75 vjeç, çka, në fakt, përkthehet në një kosto substanciale, apo domethënëse në termat e kontratës. Kjo thjesht për të sqaruar disa të dhëna nga ana jonë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Kuko!

Besoj se kjo e dhëna juaj na bëri të kemi pyetje tjetër. Këto 14 mijë e 964 persona mbi 75 vjeç, do të kenë të drejtë të votojnë me kartën që u ka mbaruar afati?

Romina Kuko – Kjo çon te pyetja e zotit Murrizi. Letërnjoftimi elektronik duhet të jetë i vlefshëm deri në momentin që ne jemi duke folur. Nëse do të ketë një nismë ligjore, apo një vendim, pa diskutim që do të kemi një realitet tjetër, por, siç e thashë, edhe pasaporta është një dokument i vlefshëm për të zbatuar procesin e votimit.

Myslim Murrizi – Zonja Kuka, ata që nuk kanë kartë, të jesh e sigurt që nuk bëhet fjalë të kenë pasaport. Madje, në numër të përgjithshëm, mes atyre që kanë kartën dhe atyre që kanë pasaport, nga informacionet që kam unë, 30% e poseduesve të kartave, nuk kanë

pasaporta. Pasaporta u ka hyrë në punë më shumë atyre që kanë mundësi financiare ose që halli u ka mundësuar të lëvizin jashtë shtetit.

Një 85 vjeçar në Çermë nuk ka nevojë për pasaportë kur nuk ka njeri në Itali, Greqi apo Gjermani, sepse harxhimi i 75 mijë lekëve janë sa për 2 muaj pension të plakut. Zgjidhja nuk është që, nëse nuk ka kartë, të votojë me pasaport. Pasaporta kushton 6-fishin e kartës. Ai, që nuk ka bërë kartë, nuk e çon ndër mend të bëjë pasaportën, sepse nuk ka pasur raste të dalë jashtë shtetit.

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolegë!

Besoje se nuk ka pyetje të tjera nga kolegët deputetë.

Unë do t'ju ftoj të kalojmë në miratimin e projektligjit.

Me këtë rast, do të doja t'iu bëja një sugjerim përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme.

Gjykoj se kemi ende probleme me shkrimin e relacionit që shoqëron projektligjet. E kemi thënë dhe stërthënë: është e nevojshme që relacionet të jetë të plotë, të mbështetura në të dhëna dhe shifra konkrete, që çdo gjë të jetë e qartë.

E bëra këtë ndërhyrje, që t'ju kujtoj edhe një herë se ne patëm disa pyetje dhe diskutime për këtë çështje, për të cilat, zëvendësministres së Brendshme, që përfaqësonte Ministrinë e Brendshme në atë kohë, i është dashur të vinte në një mbledhje tjetër të Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Pavarësisht se ne jemi komision për dhënie mendimi, çështja bazë ngelet e pandryshueshme, duhet të jetë njësoj e sqaruar dhe në mënyrë të plotë. Këtë e kam për përfaqësuesit juridikë të Ministrisë së Brendshme. Relacioni duhet të jetë i tillë, që kushdo ta lexojë, ta kuptojë, pa pasur ndoshta nevojë t'u shkojë letrave shoqëruese deri në fund.

Këtu ka edhe mungesë të letrave shoqëruese. Zoti Murrizi, me të drejtë, tha se mungon kontrata, por ne nuk do të hyjmë në këtë çështje, sepse i përket Komisionit të Ekonomisë dhe shpresoj që ata ta vlerësojnë kontratën në vetvete.

Kush është dakord me projektligjin “Për miratimin e shtesës së kontratës koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në miratimin e neneve të projektligjit.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 sanksionon që ky projektligj pasi të miratohet, do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord?

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord me projektligjin “Për miratimin e shtesës së kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike””, sikundër u citua dhe më herët? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet.

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme për prezantimin!

Kolegë, dy javët në vijim, në fakt, do të jenë javë pune për Komisionin e Sigurisë. Kështu që do të doja mirëkuptimin tuaj për të qenë prezentë në mbledhje, sepse koha është po aq e çmuar për secilin prej nesh dhe për të marrë paraprakisht dijeni për përmbajtjen e projektligjeve të propozuara.

Javën tjetër ne fillojmë me diskutimin e projektligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, që është ligji i ri për institucionin e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, që tanimë propozohet të quhet Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe jo vetëm kaq. Këshilltarët kanë vënë në dispozicion dokumentet e punës, një tabelë krahasuese si është ligji aktual i SHÇBA-së dhe si propozohet ligji i ri “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

Po kështu, do të vazhdojmë me diskutimin nen për nen të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesat në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”. Ne e kemi bërë miratimin nen për nen. Ndërkohë, Komisioni i Ligjeve, që është komision përgjegjës, ka bërë një sërë shkresash nëpërmjet të cilave u ka kërkuar disa institucioneve mendime për projektin, duke filluar nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Komiteti Shqiptar i Helsinkit e të tjera. Për të mos përsëritur të njëjtat shkresa, jemi duke pritur t’i marrim edhe ne mendimet e këtyre institucioneve dhe të kemi mundësi t’i shqyrtojmë gjatë diskutimit nen për nen të projektligjit.

Një ligj tjetër që do të na duhet të diskutojmë është një propozim i këtij komisioni, më saktë, i disa anëtarëve të nënkomisionit që monitoron vetingun në radhët e policisë së Shtetit. Ka një propozim të materializuar tanimë si një ndryshim në ligjin për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së. Kështu që ftoj të gjithë

kolegët që ende nuk janë vënë në dijeni ta marrin dhe ta shohin këtë projekt.

Një projektligj tjetër do të jetë ai “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”. Ne jemi komision përgjegjës për këtë projekt. Ka disa komisione të tjera që do të japin mendime për këtë projekt, por sidoqoftë ne do të jemi komision përgjegjës.

Po ashtu, ka ardhur ligji i ri “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe kemi edhe një projekt tjetër, që është një iniciativë e kolegut të Komisionit të Ligjeve, zotit Shameti, për një ndryshim në ligjin e antimafias nr.10192, datë 3.12.2009.

Kështu që për të gjitha këto, pa dashur t’jua ngarkoj dhe më shumë fundjavën, sipas korrespondencës që kemi me këshilltarët e Komisionit të Sigurisë, do t’u lutesha kolegëve të caktuar si relatorë të munden t’u kushtojnë pak më shumë kohë projekteve, me qëllim që të jemi sa më eficientë në punën tonë.

Ju falënderoj edhe një herë të gjithëve!

Punë të mbarë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA